

**Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË  
KËSHILLI BASHKIAK  
Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale**

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

**Nr. \_\_\_ datë 26. 01. 2026**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Delvinë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr. \_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 dhjetor 2025".

**Analiza ligjore:**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të VKM nr.617, datë 22.09.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.579, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" si edhe Rregullores se Funksionimit te Keshillit bashkiak.

**Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Përfitojnë ndihmë ekonomike në total nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri në 6% për muajin nentor 2025 gjithësej 7 familje, me një fond 23135 lekë, të cilat janë skualifikuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme si edhe bazuar në kriteret e ndihmës ekonomike.

**Situata financiare:** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Për banorët e qendrës së bashkisë Delvinë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën deri në 6%, për muajin nentor janë 6 familje më një fond 19989 leke. Ndërsa për banorët e Njësisë administrativeVergo është vetëm një familje me një fond 3146 lekë.

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**

Drejtoria e Financës, Shërbimit social dhe shëndetësor, Arsimit, Kulturës, Sportit, në bashkinë Delvinë.

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e Financës, Shërbimit social dhe shëndetësor, Arsimit, Kulturës, Sportit, në bashkinë Delvinë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

**Impakti social / grupet që preken:**

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 26.01.2026, shqyrtoi projektvendimin, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën dhjetor 2025, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

Miratimin e projektaktit

Erinda Seitaj

(emri, mbiemri, firma)

  
Kryetare e Komisionit

Roza Gjikhima

(emri, mbiemri, firma)

  
Sekretare e Komisionit